



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PRESIDENTI

7 Mars 2022 Presidenti Meta dekreton emërimin e z. Gentian Medja, gjyqtar i Gjykatës së Lartë

DEKRET

PËR

EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 136 të Kushtetutës, nenit 48, pikat 11 dhe 13, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi administrova propozimin e arsyetuar të përcjellë me shkresën me nr. 1286/2 prot., datë 02.03.2022 dhe Vendimin nr. 80, datë 02.03.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. Gentian Medja", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, procedurë kjo e shpallur për kandidim me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përfundim të shqyrtimit të këtij propozimi, vendosa të:



DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti **Gentian Medja** emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Dekretit 13497

Tiranë, më 07.03.2022

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

Shpërndaje në Rrjetet Sociale:



Arkiva

Shtator 2018

Gusht 2018



Korrik 2018

Qershor 2018

Maj 2018

Prill 2018

Mars 2018

Shkurt 2018

Janar 2018

Dhjetor 2017

Nëntor 2017

Tetor 2017

Lidhje shtetërore

Kuvendi i Shqipërisë

Këshilli i Ministrave

Gjykata Kushtetuese

Gjykata e Lartë

Prokuroria Shqiptare

Shtabi i Përgjithshëm i FA



Kontrolli i Lartë i Shtetit

ILDKP

Avokati i Popullit

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Kolegji i Posaçëm i Apelit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Avokatura e Shtetit

